



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1104/Prot
1

Datë 20.06 2016

Lënda: Dërgohen Raportet e Vlerësimeve Teknike¹ të Dokumenteve të Fazës 1 të plotësuar, dhe Fazës 2 të plotësuar, të Hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Korçë.

Drejtuar: Z. Sotirag FILO
Kryetar
Bashkia Korçë

Bashkimi i Operatorëve ekonomik BOLLES&WILLSON GmbH&CO dhe IDRA sh.p.k

Adresa: Rr. "Siri Kodra", Nr. 94, Ap.49, Njësia Bashkiake 8, Tiranë

I nderuar Z. Filo,

Bashkimi i Operatorëve ekonomik, BOLLES&WILSON GmbH&CO dhe IDRA sh.p.k. me anë të shkresës Nr. 35 Prot., datë 15.06.2016, protokolluar pranë AKPT me Nr. 1078 Prot., datë 16.06.2016, me lëndë: Dorëzim i plotësimeve të përmbajtjes për dokumentet e fazës së dytë të projektit "Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore për Bashkitë: Pogradec, Korçë", kanë dorëzuar në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për secilën nga bashkitë Pogradec, Korçë, dokumentacionin me përmbajtje:

1. *Faza 1 (e plotësuar):*
 - Raporti i Vlerësimit dhe Analizës së Gjendjes Ekzistuese
2. *Faza 2 (e plotësuar):*
 - Dokumenti i Strategjisë
3. Harta
4. CD me materialet e mësipërme.

¹ Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar; të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"; të VKM Nr. 670, datë 29.07.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për kryerjen e procedurave të prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 bashki"; Urdhrit të Ministres së Zhvillimit Urban Nr.48, datë 17.02.2016 "Për monitorimin, mbikëqyrjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratave si dhe marrjen në dorëzim të produkteve, për tenderin "Shërbim Konsulencë", me objekt Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për 26 bashkitë", i ndarë në lote"; Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit Nr. 32 datë 11.03.2016, "Për ngritjen e grupit të punës "Për monitorimin, mbikëqyrjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratave, si dhe marrjen në dorëzim të produktit, për tenderin "Shërbim Konsulencë", me objekt "Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për 26 bashkitë", i ndarë në lote"; "Termave të Referencës për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki"; të Kontratës "Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për Bashkitë: POGRADEC, KORÇË" të nënshkruar më datë 27.01.2016, nr. Prot. 514 mes palëve Ministria e Zhvillimit Urban dhe Bashkimit të Operatorëve ekonomik, BOLLES&WILSON GmbH&CO dhe IDRA sh.p.k..

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka kryer vlerësimet teknike të dokumenteve të mësipërme për Bashkinë Korçë, të cilat mund të gjenden bashkelidhur:

- Raporti i Vlerësimit Teknik për dokumentin “*Analiza dhe Vlerësimi i Territorit*”, për **Bashkinë Korçë**;
- Raporti i Vlerësimit Teknik për dokumentin “*Strategjia Territoriale*”, për **Bashkinë Korçë**.

Shënim i rëndësishëm:

Dokumenti i Strategjisë Territoriale merr përputhshërinë e plotë, me përmbushjen e të gjitha komenteve sipas pikave të Raportit të Vlerësimit Teknik përkatës për Analizën dhe Vlerësimin e Territorit (Faza 1) dhe Strategjinë Territoriale (Faza 2).

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptoi: E. Trepçi
Datë: 20.06.2016
Nr. kopjesh: 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

**ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORITⁱ
BASHKIA KORÇË**

RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK

FAZA I / Versioni 1.1

Koordinator

Z.Piro Anastasi

Koordinator

Z.Esra Trepçi

Ekspert GIS

Z. Evio Baruti

Ekspert Ligjor

Znj. Borana Laçi



20.06.2016

Rezultatet dhe Detyrat

Përputhshmëriaⁱⁱ

me VKM 671, dt. 29.07.2015 dhe Termat e Referencës për Hartimin e PPV

REZULTATI 1. Analiza e të gjitha planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standarteve

1.2. Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë

1.2.1. Analiza e planeve, strategjive, planeve sektoriale në të gjitha nivelet, përfshirë zbatueshmërinë e tyre dhe çështje që duhet të vlerësohen gjatë hartimit të planit të ri.

Në përputhje

RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*:

Në përputhje.

I nevojshëm pasqyrimi i rolit apo impaktit, të Bashkisë Korçë, me këto dokumente në fazën pasardhëse.

Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.

1.3. Dokumentimi dhe rishikimi i direktivave të planeve ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale, standarteve dhe normave.

1.3.1. Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësishë kombëtare që ndodhen në territorin e njësisë së qeverisjes vendore dhe kufizimet që rrjedhin prej tyre.

Në përputhje

RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*:

Në përputhje.

Sugjerohet pasurimi me zonat e objektet e rëndësishë kombëtare sipas kategorisë së mbrojtjes, në fazën pasardhëse.

Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.

1.3.2. Analiza e elementeve përjashtuese dhe paraqitjen e tyre grafike në hartë.

Në përputhje

RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*:

I nevojshëm specifikimi i elementeve përjashtuese në vijim të pikës 1.3.1., i zonave të tyre buferike, dhe paraqitja e tyre në një hartë të veçantë, në fazën pasardhëse.

Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.

* Referuar Raportit të Vlerësimit Teknik të Fazës I / Dorëzimi I të Analizës dhe Vlerësimit të Territorit, përgatitur nga AKPT më 20.04.2016

REZULTATI 2. Skanimi i territorit dhe vlerësimi

2.1. Vështrimi i Përgjithshëm dhe Analiza Mjedisore	2.1.1. Analiza dhe vlerësimin i pozicionimit strategjik të njësisë së qeverisjes vendore në raport me rajonin ku ajo shtrihet, përfshirë identitetin historik, urban dhe ekonomik të territorit.	<p>Në përputhje</p> <p>RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*:</p> <p><i>I nevojshëm pasqyrimi i vlerësimit të pozicionimit strategjik të njësisë së qeverisjes vendore në raport me rajonin në hartat specifike, në fazën pasardhëse.</i></p> <p><i>Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i></p>
	<p>2.1.2. Analiza e përgjithshme e gjendjes ekzistuese të territorit të njësisë vendore dhe atë metabolike të flukseve kryesore, e cila përmban elementet:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. topografik dhe klimatik; ii. gjeologo-inxhinierik; iii. hidrogeologjik dhe hidrografik; iv. makrozonimin dhe, sipas rastit, mikrozonimin sizmik; v. bonitetin e tokave, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës; vi. burimet natyrore, si mjedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate, miniera dhe të tjera të kësaj natyre, nëse ka të tilla në territorin përkatës; vii. zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike, nëse ka të tilla në territorin përkatës. 	<p>Jo në përputhje</p> <p>RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*:</p> <p><i>I nevojshëm pasqyrimi në hartën specifike, në fazën pasardhëse:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -pika i), analizës klimatike; -pika v), analizës së bonitetit të tokave. <p><i>Nuk është përmbushur pika v) e komentit të shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i></p> <p><i>E nevojshme të pasqyrohet në hartë boniteti i tokave, sapo të sigurohen të dhënat përkatëse.</i></p>
	2.1.3. Analiza mjedisore	Në përputhje
	2.1.4. Analiza e problematikës mjedisore, burimeve ndotëse dhe të dhëna për efektin e tyre në territor dhe shëndetin e njeriut	Në përputhje
	2.1.5. Analiza e përgjithshme e kushteve dhe e cilësisë fizike të strukturave e të territoreve, si bazë për hartimin e planeve të rigjenerimit, ripërtëritjes	<p>Në përputhje</p> <p>RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*:</p> <p><i>I nevojshëm plotësimi i degradimit natyror të terrenit dhe degradimit urban, në fazën</i></p>

* Referuar Raportit të Vlerësimit Teknik të Fazës I / Dorëzimi I të Analizës dhe Vlerësimit të Territorit, për gatitur nga AKPT më 20.04.2016

**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT
BASHKIA KORÇË**

AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

	dhe/ose rihvillimit	pasardhëse.
		<i>Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i>
	2.1.6. Analiza e tipologjisë hapësinore ekzistuese, bazuar në njëtrajtshmërinë e llojit dhe volumit të strukturave, mënyrën e vendosjes së tyre në njësi (strukturore), skemën e rrjetit rrugor dhe të hapësirave publike, si dhe në lartësinë e strukturave	Në përputhje RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*: <i>Në përputhje, Sugjerohet pasqyrimi në një hartë të integruar e tipologjive të hapësirave, në fazën pasardhëse.</i> <i>Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i>
	2.1.7. Analiza e elementeve të rëndësishme territoriale, natyrore apo artificiale, që kanë ndikuar ose ndikojnë në formimin e vazhdueshëm të territorit në studim	Në përputhje
2.2. Përdorimi Ekzistues i Tokës; Aktivitetet dhe Impaktet	2.2.1. Analiza e përdorimit ekzistues të tokës, bazuar në kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës, funksionet dhe aktivitetet, si dhe lidhjen e territorit vendor me rrjetet e infrastrukturave kombëtare	Në përputhje RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*: <i>E nevojshme paraqitja në një hartë të veçantë të katërmbëdhjetë kategorive bazë, sipas specifikimeve të Nenit 77 të VKM Nr. 671 datë 29.07.2015, në fazën pasardhëse.</i> <i>Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i>
2.3. Analiza dhe Vlerësimi Demografik	2.3.1. Shpërndarja dhe përqëndrimi i popullsisë në territor, lëvizjet mekanike dhe natyrore në vite	Në përputhje
2.4. Aspektet Sociale dhe Ekonomike	2.4.1. Analiza dhe vlerësimi ekonomik, përfshirë mundësitë lokale dhe pengesat për zhvillim ekonomik, konkurrueshmërinë ekonomike apo rajonale, pozicionimin dhe përqendrimin e poleve ekonomike lokale, cilësinë e kapitalit dhe të burimeve njerëzore, pika të forta apo të dobëta për zhvillimin e ardhshëm të territorit	Në përputhje

* Referuar Raportit të Vlerësimit Teknik të Fazës I / Dorëzimi I të Analizës dhe Vlerësimit të Territorit, përgatitur nga AKPT më 20.04.2016

20.06.2016



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT
BASHKIA KORÇË**

	2.4.2. Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale, përfshirë kriminalitetin, komunitetet e marginalizuara, etj.	<i>Në përputhje</i>
	2.4.3. Analiza e zhvillimit social, punësimit, edukimit, shëndetit etj.	<i>Në përputhje</i>
	2.4.4. Analiza e periferialitetit, për efekt të së cilës në territor përcaktohen zona sipas kriterëve të mëposhtme: i) largësia nga qendra/t e territorit urban; ii) largësia nga zonat ekonomike (qendrat e punësimit); iii) lidhja me rrjetin rrugor sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor; iv) furnizimi me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; v) niveli i përafërt i të ardhurave të shtresave shoqërore që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zona të caktuara; vi) plotësimi me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës; vii) niveli i kriminalitetit dhe siguria e jetës; viii) probleme të ndryshme sociale, përfshirë përjashtimin social;	<i>Jo në përputhje</i> RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016) *: <i>Në përputhje, Sugjerohet, në fazën pasardhëse, përcaktimi sipas kriterit të pikës iii) lidhja me rrjetin rrugor sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor.</i> <i>Nuk është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i> <i>E nevojshme të paraqitet harta përfaqësuese e analizës së periferialitetit, duke specifikuar lidhjen me rrjetin rrugor sipas kategorive përkatëse.</i>
	2.4.5. Analiza e nevojave për strehim për të gjitha grupet shoqërore, sipas llojit dhe cilësisë së banesave ekzistuese, shpërndarjes së tyre në territor, sipërfaqes së banimit për person dhe aksesit në shërbime	<i>Në përputhje</i>
2.5. Analiza e Infrastrukturës Ekzistuese	2.5.1. Infrastruktura rrugore, transporti dhe fluksi i lëvizjes së mjeteve (njësi/orë)	<i>Në përputhje</i> RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*: <i>I nevojshëm pasurimi me fluksin e lëvizjeve të mjeteve (njësi/orë) dhe analizën e rrjetit rrugor sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor, në fazën pasardhëse.</i> <i>Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i>

* Referuar Raportit të Vlerësimit Teknik të Fazës I / Dorëzimi I të Analizës dhe Vlerësimit të Territorit, përgatitur nga AKPT më 20.04.2016

20.06.2016



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT
BASHKIA KORÇË**

2.6. Toka dhe Çështjet e Pronës	2.6.1. Analiza e mënyrës së përdorimit të pronave publike, përfshirë vendndodhjen, funksionet dhe marrëdhëniet e pronësisë	<p>Në përputhje</p> <p>RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*:</p> <p><i>Në përputhje,</i></p> <p><i>I nevojshëm pasurimi i informacionit në hartë me detajet e përdorimit të tokës, në fazën pasardhëse.</i></p> <p><i>Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i></p> <p><i>E nevojshme të plotësohet harta përkatëse me informacionin që mungon, sapo të sigurohen të dhënat.</i></p>
	2.6.2. Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën, përfshirë konfliktet dhe situatat e informalitetit	<p>Në përputhje</p> <p>RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*:</p> <p><i>I nevojshëm pasurimi me informacionin e zonave për të cilat nuk ka informacion, dhe evidentimi i konflikteve dhe situatave të informalitetit, në fazën pasardhëse.</i></p> <p><i>Është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i></p> <p><i>E nevojshme të plotësohet harta përkatëse me informacionin që mungon, sapo të sigurohen të dhënat.</i></p>
REZULTATI 3. Përgatitja e databazës territoriale e integruar në platformën GIS		
3.1. Analiza e Situatës Aktuale	3.1.1. Analizimi i situatës së inventarit të të dhënave, “hardware” dhe “software”, burimeve njerëzore, etj.	Në përputhje
	3.1.2. Rekomandimi i veprimeve dhe masave për rritjen e efikasitetit të GIS	Në përputhje
3.2. Përditësimi i të Dhënave Ekzistuese	3.2.1. Krijimi i strukturës për së paku: - Ndërtesat: numrat e kateve, funksionet,	Në përputhje

* Referuar Raportit të Vlerësimit Teknik të Fazës I / Dorëzimi I të Analizës dhe Vlerësimit të Territorit, përgatitur nga AKPT më 20.04.2016

20.06.2016

5

**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT
BASHKIA KORÇË**

	<p>kushtet; – Infrastruktura rrugore: klasifikimi, kushtet; – Burimet ujore dhe infrastruktura e shërbimeve; – Përdorimi i tokës; – Zonat mbrojtëse të zonave të ndjeshme sipas legjislacionit shqiptar, të tilla si rrugët, uji, landfill, etj.</p>	<p>RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*; <i>Në përputhje,</i> <i>Sugjerohet që në fazën pasardhëse, plotësimi i të gjitha shtresave, plotësimi në projeksionet përkatëse dhe azhurnimi i mëtejshëm i territorit, duke mos u kufizuar vetëm në territorin e ish-Bashkisë Korçë.</i> <i>Sugjerohet të përmbushet komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i></p>
3.3. Krijimi i Strukturës së Bazës së të Dhënave	3.3.1. Konvertimi i inventarit të bashkisë në formatin e Regjistrit të Integruar të Territorit.	<p>Jo në përputhje RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*; <i>Jo në përputhje,</i> <i>I nevojshëm konvertimi i databazës së përgatitur në formatin e përcaktuar nga AKPT, në fazën pasardhëse.</i> <i>Nuk është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i> <i>E nevojshme të paraqitet databaza GIS, e konvertuar në formatin e RIT.</i></p>
		<p>Jo në përputhje RVT/ F I/ V 1.0 (datë 20.04.2016)*; <i>Jo në përputhje,</i> <i>I nevojshëm plotësimi i rezultatit me këtë fokus, në fazën pasardhëse.</i> <i>Nuk është përmbushur komenti i shprehur si më sipër për dorëzimin e parë.</i> <i>Është e nevojshme të paraqitet struktura e bazës së të dhënave, dhe plani i veprimit për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e tyre.</i></p>
	3.3.2. Përgatitja e strukturës së bazës së të dhënave dhe një plani veprimi për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave.	

ⁱ “Analiza dhe Vlerësimi i Territorit” (e plotësuar), dorëzuar pranë AKPT me anë të shkresës Nr. 35 Prot., datë 15.06.2016, protokolluar pranë AKPT me Nr. 1078 Prot., datë 16.06.2016, me lëndë: Dorëzim i plotësimeve të përmbajtjes për dokumentet e fazës së dytë të projektit “Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore për Bashkitë: Pogradec, Korçë”

20.06.2016



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT
BASHKIA KORÇË**

AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

ii Shpjegues për shprehjen e përputhshmërisë:

Rreshti 1	Përputhshmëria: Në përputhje / Jo në përputhje
Rreshti 2	Komenti sipas Raportit të Vlerësimit Teknik (RVT) V 1.0
Rreshti 3	Komenti sipas Raportit të Vlerësimit Teknik (RVT) V 1.1
Rreshti

20.06.2016





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

STRATEGJIA TERRITORIALEⁱ

BASHKIA KORÇË

RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK

FAZA II / Versioni 1.0

Koordinator

Z. Piro Anastasi

Koordinator

Znj. Esra Trepçi

Ekspert GIS

Znj. Evio Baruti

Ekspert Ligjor

Znj. Borana Laçi

20.06.2016



Rezultatet dhe Detyrat		Përputhshmëriaⁱⁱ <i>VKM Nr. 671, datë 29.07.2015, Neni 52 Termet e Referencës për Hartimin e PPV Planin e Përgjithshëm Kombëtar</i>
1. REZULTATET E ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË TERRITORIT		
1.1. Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga Planet Kombëtare dhe Sektoriale	1.1.1 Parashikimet që rrjedhin nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar	<i>Në përputhje</i>
1.2. Analiza Territoriale	1.2.1 Analiza metabolike dhe vlerësimi i përgjithshëm i territorit të njësisë vendore	<i>Në përputhje</i>
	1.2.2 Përcaktimi i territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor	<i>Në përputhje</i>
1.3. Identifikimi i nevojave, potencialeve dhe kufizimeve	1.3.1. Identifikimi për secilin nga 5 sistemet territoriale (natyror, ujor, bujqësor, urban dhe infrastrukturor) i potencialeve, elementeve kryesore të konservimit	<i>Në përputhje</i>
	1.3.2. Rekomandime për problematikat e identifikuara	<i>Në përputhje</i>

20.06.2016



2. VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE

2.1. Formulimi i vizionit dhe strategjisë për zhvillimin territorial të njësisë vendore

2.1.1. Vizioni i zhvillimit të territorit të njësisë vendore

Jo në përputhje,

E nevojshme të shtjellohet në detaje vizioni i përgjithshëm i zhvillimit të territorit, si dhe të shpjegohen në relacion hartat tematike të vizionit të paraqitura për zhvillimin e bujqësisë, turizmit, industrisë dhe energjisë.

2.1.2. Objektivat strategjike për zhvillimin e territorit të njësisë vendore

Jo në përputhje,

E nevojshme të shtjellohen në tekst objektivat strategjike të zhvillimit duke shprehur qëllimin, rëndësinë dhe impaktin që do të kenë në territorin e bashkisë.

Objektivat sjellin realizimin e vizionit territorial, duke synuar zgjidhjen e problematikave të identifikuar gjatë fazës së analizës, ndaj duhet të shpjegohet qartë arsyetimi i ndjekur për përzgjedhjen e tyre.

2.1.3. Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve, si dhe duke konsideruar projeksionet e ndryshimeve në:

- popullsi;
- aktivitet ekonomik;
- cilësi mjedisi;
- infrastrukturë publike;
- shërbime publike;
- sisteme territoriale në tërësi (konvertim nga një sistem në tjetrin);
- etj.

Jo në përputhje,

E nevojshme të sqarohet kalimi nga vizioni i përgjithshëm i territorit dhe parimet e "planit strategjik", në "dimensionet strategjike" dhe drejtimet prioritare të zhvillimit.

E nevojshme të shtjellohen në tekst drejtimet e përcaktuara për zhvillimin e territorit sipas 3 sektorëve: bujqësi, turizëm, industri dhe energji.

Për secilin prej tyre, duhet të konsiderohen impaktet që sjellin në bashki dhe projeksionet e ndryshimeve në:

- popullsi;
- aktivitet ekonomik;
- cilësi mjedisi;
- infrastrukturë publike;
- shërbime publike;
- sisteme territoriale në tërësi (konvertim nga një sistem në tjetrin).

Propozimi i konvertimit të tokës nga sistemi bujqësor në sistemin urban, duhet të jetë subjekt i konsultave me MBZHRAU dhe me

		organet e tjera kompetente, në bashkërendim me AKPT.
2.2. Hartëzimi i Vizionit dhe Strategjisë së Territorit	2.2.1. Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore si dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit	<p>Jo në përputhje,</p> <p>Është e nevojshme të paraqiten hartat e vizionit jo vetëm në brendësi të raportit të Strategjisë Territoriale, por edhe në aneksin përkatës të hartave të strategjisë territoriale, në një format të përshtatshëm.</p> <p>E nevojshme që në hartat e vizionit të paraqiten parashikimet që rrjedhin nga PPK: propozimi i zgjatimit të linjës hekurudhore Pogradec-Korçë-Kapshticë-Kastoria; rrjeti i zonave të mbrojtura; korridoret natyrore; vija blu për mbrojtjen e korridoreve natyrore.</p>
	2.2.2. Hartat që paraqesin:	<p>Jo në përputhje,</p> <p>E nevojshme paraqitja në hartë e projeksioneve/skenarëve ekonomike dhe demografike si rrjedhojë e zhvillimeve që parashikohen në territor deri në vitin 2030.</p>
	2.2.3. Hartat e 5 sistemeve ekzistuese dhe të propozuara territoriale së bashku me:	<p>Jo në përputhje,</p> <p>E nevojshme të paraqiten hartat e 5 sistemeve ekzistuese dhe të propozuara në një format të përshtatshëm, ku të kuptohet qartë referimi i gjendes aktuale apo të ardhshme.</p> <p>Hartat duhet të shoqërohen me tabelat dhe treguesit përkatës për secilin sistem, dhe evidentimin e nevojave për konvertim të sistemeve.</p>
	2.3.4. Baza e përditësueshme GIS e materialit hartografik, e konvertuar në formatin e Regjistrit të Integruar të Territorit.	<p>Jo në përputhje,</p> <p>E nevojshme të paraqitet baza e përditësueshme GIS e materialit hartografik, e konvertuar në formatin e Regjistrit të Integruar të Territorit.</p>
3. PLANI I VEPRIMEVE PRIORITARE, INVESTIMEVE STRATEGJIKE/KAPITALE DHE PROJEKTET PILOT TË ZHVILLIMIT		
3.1. Programet,	3.1.1. Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë	Jo në përputhje,

Projektet e Zhvillimit dhe Planet e tyre të Veprimit	përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë.	<i>E nevojshme të shtjellohen në tekst programet strategjike të zhvillimit dhe rrjedhimi i tyre nga vizioni i përgjithshëm, drejtimet e zhvillimit dhe objektivat strategjike.</i>
	3.1.2. Evidentimi i projekteve pilot të zhvillimit nëpërmjet identifikimit të zonave, territoreve apo subjekteve të një rëndësie të veçantë për territorin vendor që përbëjnë zonat e zhvillimit prioritar dhe që do të veprojnë si raste studimore.	<i>Në përputhje</i>
	3.1.3. Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë: - fazat dhe termat kohorë; - përgjegjësitë; - ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore; - burimet njerëzore; - buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve; - treguesit monitorues të zbatimit.	<i>Jo në përputhje,</i> <i>E nevojshme të përcaktohen në planin e përgjithshëm të veprimeve përgjegjësitë e hartimit/zbatimit të projekteve, ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore (sipas rastit), burimet njerëzore dhe treguesit monitorues të zbatimit, deri në përfundim të hartimit të PPV-së.</i> <i>Treguesit monitorues të zbatimit duhet të jenë specifik, të matshëm, të arritshëm, të vlevshëm dhe të përcaktuar në kohë.</i>
4. PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESUARA DHE TAKIMI PUBLIK		
4.1. Identifikimi i palëve të interesuara	4.1.1. Palët e interesuara duhet të përbëhen nga përfaqësues të kategorive të mëposhtme të qytetarëve: - Institucione dhe organizata qeveritare: ministritë, agjencitë, këshillat e qarqeve, bashkitë kufitare, njësitë administrative vendore; organizata ndërkombëtare; donatorë; etj. - Shoqëria civile: banues në zonën e studimit; përfaqësues të komuniteteve, forumeve; organizata jo-qeveritare; shkolla, universitete, institute kërkimore; etj. - Sektori privat: grupe interesi të fushave të ndryshme; përfaqësues të bizneseve, sipërmarrësve, organizatave private; etj.	<i>Jo në përputhje,</i> <i>E nevojshme të identifikohen në grupin e palëve të interesuara përfaqësues të qeverisjes, shoqërisë civile dhe sektorit privat që impaktohen apo impaktojnë temat subjekt të Strategjisë Territoriale, si mjedisi, ekonomia, infrastruktura, bujqësia, turizmi, zhvillimi urban, kultura, etj.</i>

**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
STRATEGJIA TERRITORIALE
BASHKIA KORÇË**

4.2. Konsultimi me palët e interesuara dhe dëgjesa publike	<p>4.2.1. Organizimi i konsultimeve me palët e interesuara, duke prezantuar gjetjet dhe rezultatet e fazave me fokus në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat e zonës: përmirësimi apo ruajtja; - Nevojat e mëdha infrastrukturore; - Nevojat social-ekonomike; - Veprime politike ose rregullatore / masa të nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të zhvillimit të zonës. 	<p>Jo në përputhje,</p> <p><i>Megjithëse janë zhvilluar dëgjesa publike dhe një anketim i publikut, është e nevojshme, të zhvillohen edhe konsultime me palët e interesuara që duhet të identifikohen më tej, të përmendura në pikën e mësipërme, 4.1.1.</i></p>
	<p>4.2.2. Përmbledhja e gjetjeve nga konsultimet me palët e interesuara; publikimi i raporteve përkatëse në Regjistrin e Integruar të Territorit dhe reflektimi i gjetjeve në dokument.</p>	<p>Jo në përputhje,</p> <p><i>Është realizuar përmbledhja e gjetjeve nga dëgjesat publike dhe anketimi, por duhet të përfshihen gjetjet nga konsultimet e nevojshme të përmendura në pikën 4.2.1.</i></p>

ⁱ “Strategjia Territoriale Bashkia Korçë”, dorëzuar pranë AKPT me anë të shkresës protokolluar me Nr. 1078 Prot., datë 16.06.2016 me lëndë “Dorëzim i plotësimeve të përmbajtjes për dokumentet e fazës së dytë të projektit “Hartimi I Planeve të Përgjithshme Vendore për Bashkitë: Pogradec, Korçë”.

ⁱⁱ Shpjegues për shprehjen e përputhshmërisë:

Rreshti 1	Përputhshmëria: Në përputhje / Jo në përputhje
Rreshti 2	Komenti sipas Raportit të Vlerësimit Teknik (RVT) V 1.0
Rreshti 3	Komenti sipas Raportit të Vlerësimit Teknik (RVT) V 1.1
Rreshti 4	Komenti sipas Raportit të Vlerësimit Teknik (RVT) V 1.2
Rreshti

20.06.2016

